



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.81, datë 28.06.2021

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB-SË NR.123, DATË 24.12.2020 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2021, SI DHE PROJEKTBUXHETIN AFATMESEM TË BASHKISË DURRËS PËR VITET 2021-2023”

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit Nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të Buxhetit”, VKB-së Nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021 si dhe projektbuxhetin afat mesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve Publike dhe Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit nr. 4 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”, si më poshtë vijon:

Pakësohet:

Emërtimi projektit	Llog. Ekonomike	Fondi në lekë
Studim fizibiliteti për menaxhimin e mbetjeve në territorin e Bashkisë Durrës	230	5,000,000
TOTALI		5,000,000

Shtohet :

Emërtimi projektit	Llog. Ekonomike	Fondi në lekë
Mobilimi i Tregut Fshatar	231	5,000,000
TOTALI		5,000,000

- Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Investimeve Publike.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.06.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURREËS

Nr. 461/10 prot.



Durrës, më 06.07.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURREËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 81 datë 28.06.2021 Për miratimin e ndryshimit të VKB-së nr.123, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2021, si dhe projektbuxhetin afatmesëm të Bashkisë Durrës për vitet 2021-2023”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
ROLAND NASTO *R. Nasto*

